

VENDIM
Nr. 17, datë 23.3.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 23.2.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 14 (Sh) 2022 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: SHIQIRI MANJANI

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 295, datë 17.12.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; nr. 20 (86-2021-229), datë 18.3.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2022-683, datë 17.3.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kthimi i çështjes për rigjykim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 33, 35, 42, 49, 57, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, 8 dhe 2 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim parashtimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Lartë të Prokurorisë (*KLP*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuarisi ka kandiduar në Shkollën e Magjistraturës për t’u pranuar në programin e formimit fillestar për magjistrat, profili prokuror, për vitin akademik 2020–2021. Aplikimi dhe dokumentacioni i paraqitur prej tij në funksion të vërtetimit të përmbushjes së kriterëve të pranimit në programin e formimit fillestar, sipas nenit 28 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 96/2016*), janë verifikuar paraprakisht nga komisioni përkatës i Shkollës së Magjistraturës në zbatim të nenit 30, pika 3, të këtij ligji, duke vlerësuar se kërkuarisi i përmbushte kriteret e kandidimit.

2. Raporti i Shkollës së Magjistraturës për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat i janë përcjellë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (*KLP*) për komente ose kundërshtime. Me vendimin nr. 124, datë 15.5.2020, *KLP*-ja ka miratuar relacionin me komentet dhe kundërshtimet për raportin e dërguar nga Shkolla e Magjistraturës dhe nuk rezulton që të ketë bërë ndonjë koment ose kundërshtim për sa i përket kërkuarisi. Më tej, bazuar në nenin 30, pika 4, të ligjit nr. 96/2016, Shkolla e Magjistraturës ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare raportin e vlerësimit përfundimtar, duke përfshirë edhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e kandidimit, ku një ndër ata ka qenë edhe kërkuarisi.

3. Në vijim, kërkuarisi ka marrë pjesë në provimin për pranimin në programin e formimit fillestar të zhvilluar nga Shkolla e Magjistraturës dhe më datë 16.7.2020 është shpallur fitues, pra

si një nga kandidatët që mund të pranohej në programin e formimit fillestar për magjistrat, profili prokuror.

4. Lista përfundimtare e kandidatëve që mund të pranoheshin në programin e formimit fillestar për magjistrat, profili prokuror, i është përcjellë KLP-së, si organi i ngarkuar nga neni 32 i ligjit nr. 96/2016 për verifikimin e plotë të pasurisë dhe figurës, që janë edhe këto kritere për t'u pranuar në programin e formimit fillestar për magjistrat. Procesi i verifikimit të pasurisë dhe figurës, përfshirë dhe për kërkuesin kandidat, ka filluar me vendimin nr. 167, datë 17.7.2020 të KLP-së. Për verifikimin e pasurisë dhe figurës së kërkuesit si relator është ngarkuar një nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (KVEVP). Të dhënat e grumbulluara nga raportimet e institucioneve përkatëse janë analizuar dhe evidentuar në relacionin e përgatitur nga relatori, i cili ka arritur në përfundimin se kërkuesi kandidat kalon testin e pasurisë dhe figurës dhe mbi këtë bazë ka propozuar pranimin e tij për në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës. Ky relacion i është njoftuar kërkuesit dhe, në mungesë të kundërshtimeve nga ana e tij, është miratuar nga KVEVP-ja. Më pas, materialet i kanë kaluar për shqyrtim e verifikim mbledhjes plenare të KLP-së.

5. Në procesin e verifikimit të kërkuesit kandidat, për sa i përket kriterit të figurës, ndër të tjera, është konstatuar se në formularin e vetëdeklarimit të plotësuar prej tij në zbatim të ligjit nr. 138/2015, datë 17.12.2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", të ndryshuar (*ligji nr. 138/2015*), pasqyrohej e dhëna se me vendimin nr. 48, datë 21.11.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, ai është dënuar me 8 muaj burgim për veprën penale "Vjedhja", të parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal (KP). Ekzekutimi i këtij vendimi është pezulluar për një afat 3-vjeçar, në zbatim të nenit 59 të KP-së dhe vendimi ka marrë formë të prerë më datë 1.12.2006. Po ashtu, është konstatuar se kërkuesi është kallëzuar penalisht në vitin 2019, kallëzim për të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Burjeve është konstatuar se kërkuesi figuron "i padënuar". Në relacionin përfundimtar KVEVP-ja ka vlerësuar se dënimi i kërkuesit në vitin 2006 nuk përbën pengesë ligjore për vijimin e procedurës për pranimin e tij në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

6. Në përfundim të shqyrtimit të rezultateve të verifikimit të pasurisë dhe figurës, me vendimin nr. 295, datë 17.12.2020, bazuar në nenin 32, pika 4, shkronja "c", të ligjit nr. 96/2016, KLP-ja ka vendosur rrëzimin e propozimit të KVEVP-së për kërkuesin dhe ndalimin e pranimin të tij në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2020–2021. Sipas këtij vendimi, ndalimi i kandidimit të kërkuesit është bazuar në nenin 28, shkronja "d", të ligjit nr. 96/2016, i cili kërkonte që kandidati të mos ishte dënuar me vendim penal të formës së prerë, si dhe në nenin 32, pika 4, shkronja "c", të tij, i cili përcaktonte mospranimin në Shkollën e Magjistraturës edhe për shkaqe të tjera përjashtuese të njohura të parashikuara nga ligji.

7. Kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e lartpërmendur të KLP-së në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila, me vendimin nr. 20 (86-2021-229), datë 18.3.2021, ka vendosur rrëzimin e padisë. Për rekursin e paraqitur nga kërkuesi, me vendimin nr. 00-2022-683, datë 17.3.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin.

8. Më datë 15.7.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të KLP-së, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Gjykatës së Lartë, që kanë vendosur ndalimin e tij për ndjekjen e programit të formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, profili prokuror.

9. Më datë 26.9.2022 njëri nga gjyqtarët e Kolegjit të Gjykatës, të cilit i ka kaluar çështja për shqyrtim, ka paraqitur dorëheqjen, çka është kërkuar edhe nga kërkuesi në kërkesën e datës 12.12.2022 drejtuar Gjykatës për përjashtimin e këtij gjyqtari. Me vendimet e datës 29.9.2022, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës së gjyqtarit për heqjen dorë dhe caktimin e një gjyqtari tjetër në përbërje të Kolegjit të Gjykatës.

10. Më datë 10.10.2022 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, më datë 28.10.2022, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë të dokumenteve.

11. Më datat 27.12.2022 dhe 23.2.2022 kanë paraqitur dorëheqjet nga shqyrtimi i çështjes edhe dy gjyqtarë të tjerë, për njërin prej të cilëve është kërkuar përjashtimi edhe nga kërkuuesi në kërkesën e datës 12.12.2022 drejtuar Gjykatës. Me vendimet e datave 10.1.2023 dhe 23.2.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesave të gjyqtarëve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procesit administrativ dhe atij gjyqësor i janë cenuar:

12.1 *Parimi i sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme*, për sa i përket *moszbatimit të ligjeve me fuqi prapavepruese*, pasi sipas nenit 62 të KP-së në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe neneve 63 dhe 69 të KP-së në fuqi në kohën e kryerjes së verifikimeve nga KLP-ja, dënimi i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë konsiderohet i paqenë dhe kërkuuesi “i rehabilituar”. Ligji nr. 96/2016 në fuqi në kohën e kandidimit nuk ndalonte ndjekjen e formimit fillestar nga individët ndaj të cilëve ekzistonte një vendim gjyqësor i paqenë. Ligji nr. 138/2015 përcakton kohëzgjatjen e ndalimit për t’u emëruar në një funksion publik si gjyqtar ose prokuror vetëm për periudhën nga momenti i përfundimit të dënimit me burgim, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të KP-së. Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ai rezulton i padënuar. Kriteri i ri i parashikuar në ligjin nr. 50/2021, të miratuar më datë 23.3.2021, i cili ndryshoi ligjin nr. 96/2016, për mosmarrjen në konsideratë të rehabilitimit të dënimit, nuk ka qenë në fuqi në kohën e vlerësimit të kandidaturës së tij dhe është zbatuar me efekt prapaveprues nga Gjykata e Lartë. Ai kishte pritshmëri të ligjshme për ndjekjen e formimit fillestar, pasi edhe në konkurrimin e tij të mëparshëm në vitin akademik 2019–2020, Shkolla e Magjistraturës dhe KLP-ja kishin pranuar se i plotësonte kriteret formale të pranimit. Ndërkohë, për të njëjtin kriter dhe mbi të njëjtat prova, në fazën e vlerësimit të pasurisë dhe figurës, KLP-ja ka vendosur ndalimin e pranimit të tij në programin e formimit fillestar. Po kështu, Gjykata e Lartë ka shkelur nenin 37, të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

12.2 *Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë*, pasi vendimet e KLP-së dhe të gjykatave janë nxjerrë në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi. Interpretimi prej tyre i nenit 32, shkronja “c”, të ligjit nr. 96/2016 është i pabazuar ligjërisht. Kërkuuesi është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës se i plotëson kriteret formale të pranimit dhe kjo nuk është kundërshtuar nga KLP-ja. Ndalimi i pranimit në formimin fillestar gjatë fazës së verifikimit të pasurisë dhe figurës mund të bëhej vetëm nëse sipas informacioneve të vëna në dispozicion të KLP-së nga organet raportuese, ai nuk i përmbushte këto kriteret. Këshillat nuk mund të ndalojnë ndjekjen e formimit fillestar të kandidatit për magjistrat bazuar në shkaqe dhe prova të cilat i kanë pasur në dispozicion paraprakisht, të përcjella nga Shkolla e Magjistraturës si pjesë e dokumentacionit të dosjes së kandidatit që në fazën para provimit. Po kështu, KLP-ja e ka bazuar vendimmarrjen e saj në projektligjin për ndryshimet e ligjit nr. 96/2016, i cili nuk është depozituar në Kuvend dhe nuk ka hyrë në fuqi. Pavarësisht se ka pranuar se ligji i kohës nr. 96/2016 kishte paqartësi në zbatimin e nenit 28, shkronja “d”, Gjykata e Lartë nuk ka vendosur pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatë. Kriteri i përcaktuar nga kjo gjykatë dhe KLP-ja për mosushttrimin e së drejtës për kontroll incidental, konkretisht mospasja në shqyrtim i çështjeve të tjera në lidhje me zbatimin e nenit 28, shkronja “d”, të ligjit nr. 96/2016, përbën një kriter të ri të paparashikuar nga Kushtetuta, ligji organik i Gjykatës dhe jurisprudenca kushtetuese.

12.3 *E drejta për një proces të rregullt ligjor* në aspektet e mëposhtme:

12.3.1 *Parimi i paanshmërisë në gjykim*, pasi Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrime të ndryshme në çështjen e tij dhe të A.K., duke u shprehur se rasti i A.K. është i vetmi kur i është dashur të zbatohet ligjin nr. 96/2016 të kohës.

12.3.2 *E drejta për t’u dëgjuar dhe mbrojtje efektive*, pasi nuk është thirrur nga KLP-ja për t’u dëgjuar në lidhje me pretendimet e tij. Mbledhja e KLP-së e datës 17.11.2020 për marrjen e vendimit është shtyrë për shkak të mosnjohjes së anëtarëve me aktet e dosjes, si dhe për t’u njohur me relacionin bashkëshoqërues të projektligjit për disa ndryshime në ligjin nr. 96/2016. Sipas procesverbaleve të mbajtura edhe në fazën e marrjes së vendimit, anëtarët e KLP-së nuk

kanë qenë të njohur me aktet e çështjes dhe nuk kanë kryer hetim të thellë dhe shqyrtim efektiv të provave në rastin e tij.

12.3.3 *Standardi i arsytimit të vendimit*, pasi KLP-ja nuk ka bërë interpretim të rrethanave të faktit në raport me ligjin në fuqi në kohën e kryerjes prej tij të veprës penale dhe, në mënyrë kontradiktore, është shprehur se duhet të përdorë si bazë ligjore ligjin nr. 138/2015, i cili nuk parashikon dënime të përrjetshme për mosmbajtjen e funksioneve të caktuara. Ajo ka bërë një arsyetim të përciptë, të pakuptueshëm dhe alogjik, duke mos adresuar asnjë prej problematikave që duhej të trajtoheshin në rastin e tij. Gjykata Administrative e Apelit i referohet nenit 149 të Kushtetutës, i cili nuk përcakton kompetencat e KLP-së për verifikimin e kandidaturave për ndjekjen e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij të paraqitura në rekurs se bazuar në dispozitat e KP-së së kohës, vendimi i dhënë ndaj tij konsiderohej i paqenë dhe se Gjykata Administrative e Apelit kishte shkelur parimin e barazisë para ligjit, për shkak të dhënies së vendimeve të ndryshme për çështje të ngjashme. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe alogjik në pjesën ku shprehet se instituti i rehabilitimit të dënimit është risi e ligjit nr. 50/2021, ndërsa pranon se ai përfshihej si ndalim në ligjin nr. 96/2016 përpara këtyre ndryshimeve. Kjo gjykatë ka përdorur riformulimin e shkronjës “d” të nenit 28 të ligjit nr. 96/2016 për të nxjerrë *ratio*-n e ligjvënësit në miratimin e parashikimit të mëparshëm.

12.4 *Parimi i barazisë para ligjit*, pasi gjykatat kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në çështje të ngjashme. Për shtetasen A.K., të dënuar me vendim penal të formës së prerë, i cili, ashtu si në rastin e tij, është pezulluar, është lejuar vijimi i kandidimit. Pavarësisht se rekursi i tij është depozituar më vonë se ai i A.K., Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar dhe ka vendosur për çështjen e tij më parë se për atë të A.K., për të cilën, në zbatim prapaveprues të ligjit nr. 50/2021, është lejuar vijimi i formimit fillestar. Të dyja çështjet janë gjykuar nga i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Lartë, ndërkohë që qëndrimet e tyre kanë qenë të ndryshme në drejtim të zbatimit të ligjit nr. 96/2016.

12.5 *E drejta për arsim*, e parashikuar nga neni 57 i Kushtetutës dhe neni 2 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si rrjedhojë e ndalimit të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Kërkuesi nuk mund të parashikonte kriteret që u aplikuan në vlerësimin e kandidaturës së tij.

12.6. *E drejta për akses në funksione publike, e drejta për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme dhe e drejta për jetë private në lidhje me parimin e proporcionalitetit*, të garantuara nga nenet 49, pika 1 dhe 17 të Kushtetutës, për shkak të skualifikimit bazuar në kritere të paparashikuara nga kuadri ligjor në fuqi. Skualifikimi përjetë nga konkurrimi në Shkollën e Magjistraturës i ka cenuar të drejtën për jetë private, në drejtim të dinjitetit, personalitetit dhe zhvillimit të marrëdhënieve me botën e jashtme. Kufizimi i të drejtave të tij është bërë nga organe jokompetente dhe përmes akteve të dala në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi. Ndërhyrja në të drejtën për jetë private është joproporcionale, pasi pasojat e një dënimi penal nuk mund të jenë të përrjetshme. Për më tepër, në kohën e kryerjes së veprës penale ai ka qenë i mitur. Qëllimet e rehabilitimit janë mbrojtja e personalitetit dhe dinjitetit të personit të dënuar, të cilit i janë kufizuar të drejtat për shkak të kryerjes së veprës penale, si dhe risocializimi i tij në jetën e përditshme. Aktualisht, Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur përjashton të miturin nga përgjegjësia penale për një vepër të tillë dhe e cilëson atë si “të mitur në konflikt me ligjin” dhe jo “të pandehur”.

13. *Subjekti i interesuar, KLP-ja*, ka parashtruar:

13.1 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e *parimit të sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme* nuk gjen mbështetje ligjore, pasi ai nuk e ka fituar ndonjëherë të drejtën për të ndjekur formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Kjo e drejtë fitohet kur plotësohen kushtet ligjore të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 96/2016, ndërkohë që kërkuesi nuk plotëson kriterin e parashikuar në shkronjën “d” të nenit 28 të këtij ligji. Fakti i të qenit i rehabilituar nuk e zbeh fuqinë e një dënimi penal.

13.2 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e *parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë* është i pabazuar. Veprimet e kryera nga KLP-ja dhe vendimmarrja e saj janë bërë në përputhje me nenet 6/1 dhe 149/a të Kushtetutës, nenin 183 të ligjit nr. 115/2016, datë 3.11.2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 115/2016*) dhe nenet 28 e 32 të ligjit nr. 96/2016, si ligj i posaçëm, i cili përcakton një standard më të lartë dhe prevalon ndaj çdo dispozite tjetër ligjore. Referencat në projektligjin për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, relacionet përkatëse, diskutimet parlamentare para miratimit dhe ndryshimet e

mëvonshme të tij janë marrë në konsideratë vetëm për krijimin e një panorame më të qartë të qëllimit të ligjvënësimit dhe jo si bazë për vendimmarrjen. Ligji nr. 50/2021 nuk ka krijuar kriter të ri, por ka plotësuar kriterin ekzistues. Kërkuesi ngatërron fazën e vlerësimit paraprak, e cila, nga pikëpamja formale, i përket Shkollës së Magjistraturës, me fazën e verifikimit të thelluar, e cila është kompetencë ekskluzive e KLP-së. Gjatë kandidimit të mëparshëm për në programin e formimit fillestar, kërkuesi nuk ka arritur fazën e verifikimit të thelluar. Kalimi i provimit nuk mjafton për t'u pranuar në Shkollën e Magjistraturës. Procedura konsiderohet e përfunduar vetëm pas verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit nga KLP-ja. Nga ana tjetër, përdorimi nga Gjykata e Lartë i mekanizmit të kontrollit incidental në lidhje me nenin 28, shkronja "d", të ligjit nr. 96/2016 në rastin e A.K. nuk do të kishte kuptim, pasi kjo dispozitë ishte shfuqizuar tashmë.

13.3 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e *parimit të paanshmërisë* nuk duhet të merret parasysh, pasi ligji nr. 96/2016 është i qartë për mënyrën se si duhet të zbatohet dhe nuk u lë hapësirë dhe diskrecion gjyqtarëve për të mbajtur qëndrim të njëanshëm. Frika e kërkuesit për njëanshmërinë e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë është e paarsyeshme dhe dyshimi i tij nuk është mjaftueshmërisht i bazuar për të vënë në dyshim vendimmarrjen e kësaj gjykate nga këndvështrimi i respektimit të standardeve kushtetuese.

13.4 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e *së drejtës për t'u dëgjuar dhe për mbrojtje efektive* është i pabazuar. Procesi i verifikimit të pasurisë dhe figurës është kryer në përputhje me dispozitat ligjore. Kërkuesi është njoftuar për relacionin për gjetjet paraprake, i cili nuk është kundërshtuar prej tij; për regjistrimin audio të seancës plenare të datës 17.11.2020, për të cilën ka paraqitur memo, si dhe materiale shitesë; është pajisur me të gjitha dokumentet e prodhuara nga KLP-ja gjatë procedurës administrative të verifikimit të pasurisë dhe figurës; ka ushtruar pa pengesë të drejtat e tij përmes paraqitjes së akteve, duke parashtruar pretendime për shtyrjen e seancës plenare etj. Po kështu, gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat janë respektuar të gjitha të drejtat e tij procedurale. Ai ka realizuar efektivisht të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova dhe për t'u mbrojtur.

13.5 Vendimet e KLP-së dhe Gjykatës së Lartë respektojnë *standardin e arsytimit të vendimit*. Pretendimet e kërkuesit për cenimin e këtij standardi, për shkak se vendimmarrja është bazuar në draftndryshime ligjore, si dhe për zbatimin e ligjit nr. 138/2015, nuk qëndrojnë, pasi vendimi i KLP-së është bazuar në ligjin e posaçëm nr. 96/2016. Po kështu, Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuesit, duke sqaruar faktin se ndalimi i kandidimit për në programin e formimit fillestar lidhet me natyrën e veprës penale të kryer dhe se nuk bëhet fjalë për trajtim të pabarabartë mes tij dhe A.K., pasi veprat e kryera nga të dy kandidatët nuk bien nën të njëjtat kushte. Vepra e kryer nga A.K. nuk diskrediton figurën e prokurorit, në ndryshim nga ajo e kryer nga kërkuesi. Pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit nga Gjykata e Lartë, për shkak se ajo është shprehur për risitë e ligjit nr. 50/2021, nuk qëndron, pasi gjykata nuk e lidh vendimmarrjen e saj me rehabilitimin.

13.6 Pretendimet për cenimin e *parimit të barazisë para ligjit* janë të pabazuara, pasi Gjykata e Lartë ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në rastin e tij, ashtu edhe të A.K. Të dyja çështjet kanë gjetur zgjidhje mbi të njëjtin arsyetim dhe interpretim ligjor. Diferencimi i dy rasteve është mbështetur mbi një kriter të arsyeshëm dhe objektiv, në kuptim të standardeve të vendosura nga ligji nr. 96/2016, që kanë të bëjnë me natyrën e veprës penale të kryer dhe ndikimin e saj te publiku. Në rastin e kërkuesit, Gjykata e Lartë ka marrë në konsideratë natyrën e veprës penale të kryer dhe pasojat që ajo sjell në raport me funksionin e prokurorit të ardhshëm, besimin e qytetarëve te reforma në drejtësi dhe mosdiskreditimin e figurës së magjistratit në tërësi. Nga ana tjetër, pretendimet e kërkuesit për rendin e trajtimit të çështjes së tij dhe të A.K. mbeten në kuadër të supozimeve dhe hipotezave për mënyrën se si Gjykata e Lartë rregullohet dhe organizon shqyrtimin e çështjeve në dhomën e këshillimit.

13.7 Kërkuesit nuk i është cenuar e *drejta për arsim*, pasi skualifikimi i tij nga kandidimi është bërë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 96/2016, ligjit nr. 115/2016, vendimit nr. 171, datë 27.9.2019 të KLP-së "Për miratimin e Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", të ndryshuar (vendimi nr. 171/2019), si dhe për shkak të mosplotësimit të kërkesave ligjore.

13.8 Kërkuesit nuk i janë cenuar *e drejta për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme dhe e drejta për jetë private, dinjitet e personalitet, në lidhje me parimin e proporcionalitetit*. Kriteret për pranimin në formimin fillestar përfshijnë aftësitë dhe cilësitë e nevojshme fizike, profesionale dhe të figurës për kandidatët për pranim në këtë program. Skualifikimi i kërkuesit është bërë bazuar në nenet 28, shkronja “d” dhe 32 të ligjit nr. 96/2016, për shkak të dënimit penal të tij me vendim të formës së prerë. Këto kriteret synojnë ushtrimin e funksionit të prokurorit nga individë me integritet të plotë, si parakusht për besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Po kështu, pretendimet për cenimin e *parimit të proporcionalitetit* janë të pabazuara, pasi ushtrimi i veprimtarisë kushtetuese dhe ligjore të prokurorëve të ardhshëm mund të kufizohet dhe fakti i ekzistencës së një dënimi penal përbën kriter ndalues për pranimin në formimin fillestar të Shkollës së Magistraturës. Në zbatim të këtij parimi, KLP-ja ka verifikuar nëse ekzistenca e të dhënave penale në ngarkim të kërkuesit është në përputhje me integritetin e nevojshëm për ushtrimin e detyrës së prokurorit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

14. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Një kriter tjetër që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Për plotësimin e këtij kriteri, kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 38, datë 2.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme të zgjedhur vetë dhe së drejtës për jetë private, në drejtim të dinjitetit, pavarësisht se ato nuk janë parashtruar si të tilla në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë ose në prapësimet e kërkuesit ndaj kundërrekursit, Gjykata vlerëson se ato qëndrojnë në thelb të kërkimeve të tij. Po kështu, pretendimet e tjera janë parashtruar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se në lidhje me to kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës.

18. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 17.3.2022, ndërsa

ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë më datë 15.7.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme, parimit të barazisë para ligjit, së drejtës për t'u dëgjuar dhe për mbrojtje efektive, standardit të arsytimit të vendimit, së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme dhe për jetë private, në drejtim të dinjitetit, dhe joproporcionalitetit të ndërhyrjes në këto të drejta, pretendime të cilat përfshihen në juridiksionin kushtetues.

20. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuetit se ligji nr. 96/2016 në fuqi në kohën e kandidimit nuk ndalonte ndjekjen e programit të formimit fillestar për magistrat nga individët ndaj të cilëve ekzistonte një vendim gjyqësor i paqenë, se ligji nr. 50/2021 është zbatuar nga Gjykata e Lartë me efekt prapaveprues, se kjo e fundit ka shkelur nenin 37 të ligjit nr. 49/2012, si dhe pretendimet për cenimin e parimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, kanë të bëjnë me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit në çështjen konkrete, çka nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, nëse nuk provohet se ka cenuar të drejtat kushtetuese. Ashtu sikundër kjo Gjykatë ka theksuar, interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 6, datë 16.2.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë nuk është ngritur në nivel kushtetues, në drejtim të testit subjektiv dhe objektiv të vlerësimit të cenimit të kësaj të drejte.

21. Për sa i përket së drejtës për arsim, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuetit lidhur me të drejtën për arsim, në thelb, ka të bëjë me aksesin në funksione publike, pavarësisht se ky lloj arsimimi në Shkollën e Magistraturës përbën parakusht për emërimin në funksionin e magistratit. Për rrjedhojë, në vijim, Gjykata do të analizojë thelbin e këtyre pretendimeve të kërkuetit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për mbrojtje efektive

22. Kërkuesi ka pretenduar se në shkelje të parimit të kontradiktoritetit në gjykim, ai nuk është thirrur nga KLP-ja për t'u dëgjuar në lidhje me pretendimet e tij. Po kështu, mbledhja e KLP-së e datës 17.11.2020 për marrjen e vendimit është shtyrë për shkak të mosnjohjes së anëtarëve me aktet e dosjes, si dhe për t'u njohur me relacionin bashkëshoqërues të projektligjit për disa ndryshime në ligjin nr. 96/2016. Sipas procesverbaleve të mbajtura, edhe në marrjen e vendimit, anëtarët e KLP-së nuk kanë qenë të njohur me aktet e çështjes dhe nuk kanë kryer hetim të thellë dhe shqyrtim efektiv të provave në rastin e tij.

23. Subjekti i interesuar, KLP-ja, ka prapësuar se procesi i verifikimit të pasurisë dhe figurës është kryer në përputhje me dispozitat ligjore. Kërkuesi është njoftuar për relacionin për gjetjet paraprake, i cili nuk është kundërshtuar prej tij; për regjistrimin audio të seancës plenare të datës 17.11.2020 për të cilën ka paraqitur memo, si dhe materiale shtesë; është pajisur me të gjitha dokumentet e prodhuara nga KLP-ja gjatë procedurës administrative të verifikimit të pasurisë dhe figurës; ka ushtruar pa pengesë të drejtat e tij përmes paraqitjes së akteve, duke parashtruar pretendimet e tij për shtyrjen e seancës plenare etj. Po kështu, gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar nga gjykatat janë respektuar të gjitha të drejtat e tij procedurale, kërkuesi ka realizuar efektivisht të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova dhe për t'u mbrojtur.

24. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat kushtetuese dhe ato ligjore nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për proces të rregullt ligjor nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ. Në këtë kuptim, çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore, është i detyruar të respektojë standardet që lidhen me procesin e rregullt, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e

personit me faktet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për proces të rregullt. Gjykata ka pohuar, gjithashtu, se e drejta për t'u dëgjuar, si pjesë e së drejtës së mbrojtjes, garantohet edhe në procesin administrativ përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimit të argumenteve prej tij ose avokatit të zgjedhur (*shih vendimin nr. 38, datë 2.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata ka theksuar se parametrat kushtetues që garantojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor, në radhë të parë, duhet të parashikohen nga legjislacioni procedural dhe, më pas, duhet të përmbushen nga organet e administratës publike nëpërmjet zbatimit të dispozitave ligjore, konkretisht të Kodit të Procedurës Administrative. Në këtë këndvështrim, kur ankimi kushtetues individual ka në objektin e tij mënyrën se si kanë vepruar organet e pushtetit publik, atëherë kontrolli kushtetues ushtrohet për të verifikuar nëse organi administrativ ka përmbushur detyrimet ligjore në atë masë që të jetë respektuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt ligjor dhe, në vijim, nëse gjykatat e zakonshme, që kanë shqyrtuar veprimet dhe vendimmarrjen e organit administrativ, kanë vepruar në përputhje me parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit, siç është pohuar edhe në jurisprudencën kushtetuese, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është në radhë të parë funksion i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 13, datë 9.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke iu referuar rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata vëren se në procesin administrativ të zhvilluar nga KLP-ja, relacioni i anëtares relatore, ku pasqyroheshin edhe të dhënat e rezultuara nga verifikimi i kandidaturës, i është njoftuar kërkuarit me *e-mail* dhe, në mungesë të kundërshtimeve nga ana e tij, KVEVP-ja ka miratuar relacionin përfundimtar, duke propozuar vijimin e procedurës së kandidimit për të. Relacioni përfundimtar i ka kaluar më pas për vendimmarrje KLP-së (*shih vendimin nr. 295, datë 17.12.2020 të KLP-së, faqja 3, pikat 7–8*) dhe nga materialet e depozituara së bashku me kërkesën nuk rezulton që gjatë fazës së vendimmarrjes KLP-ja të ketë administruar akte të tjera për verifikimin e kandidaturës së tij në zbatim të ligjit nr. 96/2016. Për më tepër, pasi është njohur me regjistrimin audio të mbledhjes plenare të KLP-së të datës 17.11.2020, në datat 23.11.2020 dhe 1.12.2020, kërkuari ka dërguar parashtrime në lidhje me rehabilitimin për shkak të dënimit penal, materiale ligjore për ndryshimet e nenit 28 të ligjit nr. 96/2016 në projektligjin e shtruar për diskutim në Kuvend, si dhe diskutimet e zhvilluara në Kuvend për këto ndryshime (*shih vendimin nr. 295, datë 17.12.2020 të KLP-së, faqja 7, pika 24*).

27. Për sa më lart, i gjithë procesi administrativ është realizuar mbi bazë të dokumenteve, të cilat rezulton se i janë bërë të ditura rregullisht kërkuarit, ndërkohë që ai ka paraqitur pretendimet e tij në lidhje me shkakun përjashtues të ngritur, atë të qenies i dënuar me vendim penal të formës së prerë, ndaj dhe Gjykata çmon se nuk verifikohet të ketë cenim të së drejtës për t'u dëgjuar. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për mbrojtje efektive është i papabazuar.

B.2 Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit

28. Kërkuari ka pretenduar se KLP-ja nuk ka bërë interpretim të rrethanave të faktit në raport me ligjin në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale nga kërkuari dhe, në mënyrë kontradiktore, është shprehur se duhet të përdorë si bazë ligjore ligjin nr. 138/2015, i cili nuk parashikon dënime të “përrjetshme” për mosmbajtjen e funksioneve publike të caktuara. Ajo ka bërë një arsyetim të përciptë, të pakuptueshëm dhe alogjik, duke mos adresuar asnjë prej problematikave që duhej të trajtoheshin në rastin e tij. Gjykata Administrative e Apelit i referohet nenit 149 të Kushtetutës, i cili nuk përcakton kompetencat e KLP-së për verifikimin e kandidaturave për ndjekjen e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij të paraqitura në rekurs se bazuar në dispozitat e KP-së së kohës, vendimi i dhënë ndaj tij konsiderohej i pagënë dhe se Gjykata Administrative e Apelit ka shkelur parimin e barazisë para ligjit, për shkak të dhënies së vendimeve të ndryshme për çështje të ngjashme. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë është kontradiktor dhe alogjik në pjesën kur shprehet se instituti i rehabilitimit të dënimit është risi e ligjit nr. 50/2021, ndërsa pranon se ai përfshihej si ndalim në ligjin nr. 96/2016 përpara këtyre ndryshimeve. Kjo gjykatë ka përdorur riformulimin e

shkronjës “d” të nenit 28 të ligjit nr. 96/2016 për të nxjerrë *ratio*-n e ligjvënësit në miratimin e parashikimit të mëparshëm.

29. Subjekti i interesuar, KLP-ja, ka prapësuar se pretendimet e kërkuarit për cenimin e këtij standardi, për shkak se vendimmarrja është bazuar në draftndryshime ligjore dhe për zbatimin e ligjit nr. 138/2015 nuk qëndrojnë, pasi vendimi i KLP-së është bazuar në ligjin e posaçëm nr. 96/2016. Po kështu, Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuarit, duke sqaruar faktin se ndalimi i kandidimit për në programin e formimit fillestar lidhet me natyrën e veprës penale të kryer dhe se nuk bëhet fjalë për trajtim të pabarabartë mes tij dhe A.K., pasi veprat e kryera nga të dy kandidatët nuk bien nën të njëjtat kushte. Vepra e kryer nga A.K. nuk diskrediton figurën e prokurorit, në ndryshim nga ajo e kryer nga kërkuari. Pretendimi i tij për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Lartë, për shkak se ajo është shprehur për risitë e ligjit nr. 50/2021, nuk qëndron, pasi gjykata nuk e lidh vendimmarrjen e saj me rehabilitimin.

30. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 4.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimin nr. 43, datë 27.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Sipas Gjykatës, nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e këtyre gjykatave. Në aspektin e kontrollit kushtetues Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 23, datë 10.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata rithekson se detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se vendimet e KLP-së dhe të gjykatave përmbajnë rrethanat e faktit, pretendimet e kërkuarit, ligjin e zbatueshëm, si dhe arsyetimin dhe vlerësimin për çështjen e tij. Sikundër vendimi i KLP-së, edhe vendimet e gjykatave përmbajnë pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i tyre, rrjedhojë e së cilës është dispozitivi i vendimeve përkatëse. Vendimet nuk rezultojnë të jenë të paqarta, alogjike ose në mungesë të elementeve formale.

33. Po kështu, veçanërisht pretendimet se Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në rekurs se dënimi penal i dhënë ndaj tij konsiderohej i paqenë, si dhe për cenimin e parimit të barazisë para ligjit nga Gjykata Administrative e Apelit, janë pasqyruar në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe janë trajtuar në pjesën përshkuese arsyetuese të tij (*shih vendimin nr. 00-2022-683, datë 17.3.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, faqet 7, 12 dhe 14-17, paragrafët 30–36 dhe 41–52*).

34. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është i pabazuar.

B.3 Për cenimin e parimit të barazisë para ligjit

35. Kërkuari ka pretenduar se gjykatat kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në çështje të ngjashme me atë të tij. Për shtetasen A.K., të dënuar me vendim penal të formës së prerë, i cili, ashtu si në rastin e tij, është pezulluar, është lejuar vijimi i kandidimit. Pavarësisht se rekursi i tij është depozituar më vonë se ai i A.K., Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar dhe ka vendosur për çështjen e tij më parë se për atë të A.K., për të cilën, në zbatim prapaveprues të ligjit nr. 50/2021, është lejuar vijimi i formimit fillestar. Të dyja çështjet janë gjykuar nga i njëjti trup gjykues i Gjykatës së Lartë, ndërkohë që qëndrimet e tyre kanë qenë të ndryshme në drejtim të zbatimit të ligjit nr. 96/2016.

36. Subjekti i interesuar, KLP-ja, ka prapësuar se Gjykata e Lartë ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në rastin e tij, ashtu edhe atë të A.K., pasi të dyja çështjet kanë gjetur zgjidhje për të njëjtin arsyetim dhe interpretim ligjor. Diferencimi i të dyja rasteve është mbështetur mbi një kriter të arsyeshëm dhe objektiv, në kuptim të standardeve të vendosura nga ligji nr. 96/2016, që ka të bëjë me natyrën e veprës penale të kryer dhe ndikimin e saj te publiku. Në rastin e kërkuarit, Gjykata e Lartë ka marrë në konsideratë natyrën e veprës penale të kryer dhe pasojat që ajo sjell në raport me funksionin e prokurorit të ardhshëm, besimin e qytetarëve te reforma në drejtësi dhe mosdiskreditimin e figurës së magistratit në tërësi. Nga ana tjetër, pretendimet e kërkuarit për rendin e trajtimit të çështjes së tij dhe të A.K. mbeten në kuadër të supozimeve dhe hipotezave për mënyrën se si Gjykata e Lartë rregullohet dhe organizon shqyrtimin e çështjeve në dhomën e këshillimit.

37. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se neni 18 i Kushtetutës parashikon se të gjithë duhet të jenë të barabartë përpara ligjit. Parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore (*shih vendimin nr. 27, datë 29.6.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Barazia në ligj dhe përpara ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Megjithatë, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përligjet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive (*shih vendimet nr. 52, datë 24.7.2017; nr. 60, datë 16.9.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Gjykata rithekson se sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor dhe se, bazuar në parimin e subsidiaritetit, interpretimi i ligjit material ose procedural është, së pari, detyrë e Gjykatës së Lartë. Gjykata ndërhyr vetëm atëherë kur, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese (*shih vendimin nr. 19, datë 7.7.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata konstaton se si vendimi i dhënë nga Gjykata e Lartë ndaj kërkuarit, ashtu edhe ai për shtetasen A.K. janë marrë nga i njëjti trup gjykues. Në të dyja rastet, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se, si para, ashtu edhe pas ndryshimeve të ligjit nr. 96/2016, qëllimi i ligjvënësit ka qenë ndalimi i futjes në sistemin gjyqësor të personave të dënuar me vendim penal të formës së prerë. Sipas gjykatës, ndryshimet e ligjit kanë parashikuar një element favorizues, duke i dhënë hapësirë diskrecionare organit për të vlerësuar kriterin ndalues vetëm për ato dënime që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose të prokurorit apo dëmtojnë rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Po kështu, Gjykata e Lartë ka çmuar se elementet që duhet të merren në konsideratë nga këshilli ose Gjykata Administrative e Apelit, për të vlerësuar nëse ekzistenca e rekordeve penale në ngarkim të kandidatit për magistrat është ose jo në përputhje me integritetin e nevojshëm për ushtrimin e detyrës, do të çmohet rast pas rasti, duke pasur në vëmendje parimin thelbësor se në një demokraci funksionale, besimi i publikut në integritetin e sistemit gjyqësor është jetik. Për më tepër, ky parim merr rëndësi, duke pasur në konsideratë kushtet që diktuan ndërmarrjen e një reforme të thellë në sistemin gjyqësor në vitin 2016.

40. Në rastin e kërkuarit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se “Vjedhja” përbën një vepër të rëndë penale, të tillë që diskrediton figurën e funksionarit publik, për më tepër kur i atribuohet figurës së një gjyqtari ose prokurori. Sipas saj, parashikimet në ligjin nr. 96/2016 janë garanci për respektimin e interesit publik dhe vijnë për shkak të nevojës dhe domosdoshmërisë që mbart integriteti si element thelbësor i funksionit të magistratit. Për shkak të natyrës së funksionit që kryen në shoqëri, integriteti i magistratit është më shumë se virtyt, është një domosdoshmëri, sepse besimi i publikut tek institucionet e drejtësisë nuk varet vetëm nga profesionalizimi i tyre, por edhe nga integriteti moral. Magistrati ose kandidati për magistrat, i cili është subjekt që së shpejti pritët të jetë pjesë e sistemit të drejtësisë, duhet që gjithmonë dhe jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, por kurdoherë të sillet me nder dhe të jetë i virtytshëm që të kontribuojë në rritjen e besimit të qytetarëve te sistemi, profesionistët e sistemit të drejtësisë dhe të jetë në

gjendje që të ofrojë besueshmëri (*shih vendimin nr. 00-2022-683, datë 17.3.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, faqet 16–17*). Po kështu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se edhe nëse aplikohet kriteri favorizues i shtuar me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 50/2021, që lidhet me diskrecionin e organit, sërish paditësi (kërkuesi), me gjithë kohën që ka kaluar nga kryerja e veprës, nuk vlerësohet se është në pozita përfituese, për shkak të vetë natyrës që ka vepra penale e kryer. Sipas gjykatës, ligjvënësi e ka lidhur kriterin ndalues me natyrën e veprës penale të kryer dhe jo me kushtet dhe rrethanat, në të cilat autori ka realizuar veprën penale. Kësisoj, nuk mund të analizohet si kriter lehtësues fakti që paditësi (kërkuesi) këtë vepër e ka kryer kur ka qenë i mitur. Vjedhja është një vepër penale, e cila për nga natyra e saj konsiderohet e rëndë. Ajo realizohet me dashje dhe, nga ana tjetër, nuk është një vepër që për nga natyra e saj, të mund të krijojë ndonjë perceptim për moskonsiderimin diskreditues për një funksionar publik, për më tepër kur i atribuohet figurës së një gjyqtari ose prokurori (*shih paragrafin 51 të vendimit nr. 00-2022-683, datë 17.3.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

41. Ndërsa në rastin e A.K., të dënuar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2019 për veprën penale “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i KP-së, ekzekutimi i të cilit është pezulluar si në rastin e kërkuesit, Gjykata e Lartë e ka vlerësuar të drejtë vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit për lejimin e kandidimit, ku pasi ka vënë në diskutim nëse vepra penale në fjalë është e tillë që të konsiderohet e papajtueshme me ushtrimin e detyrës së magjistratit, në kuptim të nenit 28, shkronja “d”, të ligjit nr. 96/2016, ka arritur në përfundimin se sjellja e parregullt e paditëses A.K. nuk cenon rëndë besimin e publikut të gjerë në sistemin e drejtësisë. Sipas gjykatës, kjo vepër penale, që për nga natyra e saj duhet domosdoshmërisht të lidhet me efektin diskreditues të pozitës dhe figurës së magjistratit, nisur nga mënyra e kryerjes, e mosardhjes së pasojës dhe momentit të kryerjes (kohë përpara se kandidatja të fitonte konkursin në Shkollën e Magjistraturës), nuk reflekton elemente të një sjelljeje diskredituese të funksionit shtetëror, që mund të përbëjë rrezik për cenimin e interesave shtetërorë. Sjellja e paditëses nuk rezulton t’i ketë sjellë ndonjë dëm efektiv të drejtpërdrejtë shtetit, të mirës publike, shoqërisë në përgjithësi, ose individëve në veçanti. Gjithashtu, kjo sjellje nuk dëshmon mangësi eventuale të paditëses në ushtrimin me korrektësi të detyrës ose ndonjë paaftësi profesionale (*shih paragrafin 50 të vendimit nr. 00-2022-751, datë 25.3.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

42. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata konstaton se specifikat e çështjes së kërkuesit dhe asaj të A.K. janë të ndryshme. Gjykata vlerëson se interpretimi që Gjykata e Lartë i ka bërë nenit 28, shkronja “d”, të ligjit nr. 96/2016, në drejtim të kufizimit të së drejtës së kërkuesit për të ndjekur formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për shkak të dënimit penal të tij me vendimin nr. 48, datë 21.11.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, nuk rezulton të ketë cenuar parimin e barazisë së individëve përpara ligjit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës.

43. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e barazisë përpara ligjit është i pabazuar.

B.4 Për cenimin e parimit të sigurisë juridike

44. Kërkuesi ka pretenduar se sipas nenit 62 të KP-së në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe neneve 63 dhe 69 të KP-së në fuqi në kohën e kryerjes së verifikimeve nga KLP-ja, dënimi i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë konsiderohet i paqenë dhe ai konsiderohet “i rehabilituar”. Ligji nr. 138/2015 përcakton kohëzgjatjen e ndalimit për t’u emëruar në një funksion publik si gjyqtar ose prokuror vetëm për periudhën nga momenti i përfundimit të dënimit me burgim, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të KP-së. Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ai rezulton i padënuar. Kriteri i ri i parashikuar në ligjin nr. 50/2021 për mosmarrjen në konsideratë të rehabilitimit të dënimit nuk ka qenë në fuqi në kohën e vlerësimit të kandidaturës së tij dhe është zbatuar me efekt prapaveprues nga Gjykata e Lartë. Kërkuesi kishte pritshmëri të ligjshme për ndjekjen e formimit fillestar, pasi edhe në konkurrimin e tij të mëparshëm, në vitin akademik 2019–2020, ashtu edhe gjatë fazës fillestare të konkurrimin për atë vit akademik, Shkolla e Magjistraturës dhe KLP-ja kanë pranuar se i plotësonte kriteret formale të pranimit në programin e formimit fillestar për magjistrat. Ndërkohë, për të njëjtin kriter dhe mbi të njëjtat prova, në fazën e vlerësimit të pasurisë dhe figurës, KLP-ja ka vendosur ndalimin e pranimit të tij në

programin e formimit fillestar për magistrat. Po kështu, Gjykata e Lartë ka shkelur nenin 37 të ligjit nr. 49/2012.

45. Subjekti i interesuar, KLP-ja, ka prapësuar se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, për sa u përket pritshmërive të ligjshme, nuk gjen mbështetje ligjore, pasi ai nuk e ka fituar ndonjëherë të drejtën për të ndjekur formimin fillestar në Shkollën e Magistraturës. Kjo e drejtë fitohet kur plotësohen kushtet ligjore të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 96/2016, ndërkohë që kërkuari nuk plotëson kriterin e parashikuar në shkronjën “d” të nenit 28 të këtij ligji. Fakti i të qenit i rehabilituar nuk e zbeh fuqinë e një dënimi penal.

46. Gjykata ka vlerësuar se siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca kushtetuese, përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuara në nenin 4 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 11, datë 16.4.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që nëse gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 4, datë 21.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuari ka marrë pjesë në provimin për pranimin në programin e formimit fillestar të zhvilluar nga Shkolla e Magistraturës. Më datë 16.7.2020 ai është shpallur fitues, pra si një nga kandidatët që mund të pranohej në programin e formimit fillestar për magistrat, profili prokuror, për rrjedhojë i është nënshtruar procedurës së verifikimit të pasurisë dhe figurës. Në relacionin përfundimtar KVEVP-ja ka konstatuar, ndër të tjera, se sipas formularit të vetëdeklarimit të plotësuar në zbatim të ligjit nr. 138/2015, kërkuari është dënuar me 8 muaj burgim me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë, ekzekutimi i të cilit është pezulluar dhe sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve rezulton “i padënuar”. Në përfundim, KVEVP-ja ka vlerësuar se dënimi penal i kërkuarit në vitin 2006 nuk përbënte pengesë ligjore për vijimin e procedurës për pranimin në programin e formimit fillestar për magistrat.

48. Me vendimin nr. 295, datë 17.12.2020, pasi ka vënë në diskutim ekzistencën e kriterit ndalues sipas nenit 28, shkronja “d”, të ligjit nr. 96/2016, për pranimin në programin e formimit fillestar për magistrat, si dhe është njohur me kundërshtimet e kërkuarit për këtë moment, KLP-ja ka vendosur rrëzimin e propozimit të KVEVP-së dhe ndalimin e pranimit të kërkuarit në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magistraturës për vitin akademik 2020–2021, duke vlerësuar se, bazuar në nenin 6/1 të Kushtetutës dhe nenin 32 të ligjit nr. 96/2016 si organ kompetent kontrollues për të vendosur për pranimin e kandidatëve në formimin fillestar për magistrat, profili prokuror, ka detyrimin të deklarojë si të papranueshëm ata kandidatë që gjenden në rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publik, për shkak të mungesës së integritetit të nevojshëm për të ushtruar funksionet brenda sistemit gjyqësor shqiptar (*shih vendimin nr. 295, datë 17.12.2020 të KLP-së, faqja 10*).

49. Gjykata vëren se i njëjti qëndrim është mbajtur edhe nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Gjykatat kanë vlerësuar se Kushtetuta dhe ligji nr. 96/2016 e kanë ngarkuar KLP-në për verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatëve. Kërkuari është dënuar me vendim penal të formës së prerë, ndërsa shkronja “d” e nenit 28 të ligjit nr. 96/2016 e përjashton rehabilitimin. Në analizë të *ratio*-s së ligjvënësit në përcaktimin e kriterit kufizues në lidhje me nenin 28, shkronja “d”, të ligjit nr. 96/2016, ekzistenca e një vendimi dënimi të formës së prerë konsiderohet kriter ndalues. Ligji i posaçëm nr. 96/2016 nuk e lidh kriterin ndalues me mënyrën se si është ekzekutuar dënimi ose ndryshimet në pasojat që sjell një masë dënimi e përcaktuar si pasojë e deklarimit fajtor të të pandehurit. Një kufizim i tillë është në funksion të garantimit të integritetit, i cili është qenësor për veprimtarinë e mirëfilltë të një magjistrati. Si përpara dhe pas ndryshimeve, qëllimi i ligjvënësit ka qenë ndalimi i futjes në sistemin gjyqësor të personave të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, pavarësisht se i dënuari është rehabilituar apo dënimi më pas është konsideruar i paqenë (*shih vendimet nr. 20 (86-2021-229), datë 18.3.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit, faqet 20–21 dhe 24; nr. 00-2022-683, datë 17.3.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, faqet 14–16*).

50. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata konstaton se, në mbështetje të ligjit nr. 96/2016, i cili ka përcaktuar kriteret e pranimit në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të vendimit nr. 171/2019 të KLP-së, i cili ka rregulluar procedurën administrative të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për prokurorë, si dhe të ligjit nr. 138/2015, kërkuesi i është nënshtruar procesit të verifikimit të kriterëve të pasurisë dhe pastërtisë së figurës, në përfundim të të cilit KLP-ja ka vlerësuar se nuk e plotëson kriterin e dytë. Vendimi i KLP-së është vlerësuar i drejtë nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë, të cilat kanë vendosur mospranimin e ankimit dhe të rekursit të tij.

51. Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme, pasi ai ka kaluar me sukses provimin e pranimit për në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndërkohë që KLP-ja ka vendosur ndalimin e pranimit të tij në këtë program gjatë fazës së verifikimit të pasurisë dhe figurës, nuk përbëjnë argumente kushtetuese për cenimin e kësaj të drejte. Vlerësimi paraprak nga Shkolla e Magjistraturës i kriterëve të kandidimit, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati në funksion të pjesëmarrjes në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar për magistrat, sipas ligjit përbën një fazë të ndërmjetme, e cila pasohet nga verifikimet e mëtejshme të thelluara nga KLP-ja, si organi i ngarkuar nga ligji nr. 96/2016 (neni 32) për verifikimin e plotë të pasurisë dhe figurës, kriterë këto që duhen të plotësohen nga kandidati për t'u pranuar në programin e formimit fillestar për magistrat. Vetëm përfundimi i këtij procesi mund të passjellë pritshmëri për të drejtat dhe interesat e ligjshëm të kërkuesit, në kuptim të pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

52. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të pritshmërive të ligjshme është i pabazuar.

B.5 Për cenimin e së drejtës për akses në funksione publike, së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme dhe së drejtës për jetë private të lidhur me parimin e proporcionalitetit

53. Kërkuesi ka pretenduar se e drejta për t'u zgjedhur ose emëruar në një funksion publik i është kufizuar në mënyrë joproporcionale, çka bie ndesh me nenin 17 të Kushtetutës. Ai është skualifikuar bazuar në kriterë që nuk parashikohen nga kuadri ligjor në fuqi. Pamundësia e ushtrimit të profesionit i ka cenuar edhe të drejtën e tij për jetë private, pasi është skualifikuar përjetë nga konkurrimi në Shkollën e Magjistraturës. Ndërhyrja në këtë të drejtë është joproporcionale, pasi pasojat e një dënimi penal nuk mund të jenë të përhershme. Për më tepër, në kohën e kryerjes së veprës penale ai ka qenë i mitur. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur e përjashton të miturin nga përgjegjësia penale për një vepër të tillë dhe e cilëson atë si “të mitur në konflikt me ligjin” dhe jo “të pandehur”.

54. Subjekti i interesuar, KLP-ja, ka parashtruar se skualifikimi i kërkuesit nga kandidimi është bërë në përputhje me ligjet nr. 96/2016 dhe nr. 115/2016, si dhe vendimin e saj nr. 171/2019. Ushtrimi i veprimtarisë kushtetuese dhe ligjore të prokurorëve të ardhshëm mund të kufizohet dhe fakti i ekzistencës së një dënimi penal përbën kriter ndalues për pranimin në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës. Ndalimet e vendosura në këtë të drejtë nga ligji nr. 96/2016 e justifikojnë plotësisht qëllimin e ligjvënësit për ushtrimin e funksionit të prokurorit nga individë me integritet të plotë, si parakusht për besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Në zbatim të këtij parimi, KLP-ja ka verifikuar nëse ekzistenca e të dhënave penale në ngarkim të kërkuesit është në përputhje me integritetin e nevojshëm për ushtrimin e detyrës së prokurorit.

55. Gjykata vlerëson të ndalet fillimisht në analizën e pretendimit të cenimit të së drejtës për akses në funksione publike, bashkë me pretendimin për të drejtën për të fituar jetesën me mjete të ligjshme, duke i trajtuar ato si të drejta kushtetuese që mund të kufizohen vetëm me ligj, ndërsa pretendimet për cenimin e së drejtës për jetë private do t'i trajtojë më vete.

56. Sipas nenit 148/ç të Kushtetutës, prokurorë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga KLP-ja pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së verifikimit paraprak të pasurisë dhe figurës së tyre, sipas ligjit. Kriteret e tjera për përzgjedhjen dhe emërimin e prokurorëve parashikohen me ligj. Nga ana tjetër, sipas nenit 49, pika 1, të Kushtetutës, secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vetë profesional.

57. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për punë, sipas nenit 49, pika 1, të Kushtetutës, përfshin zgjedhjen e profesionit, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit

profesional, me qëllim sigurimin e mjeteve të jetesës në mënyrë të ligjshme. Zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, është një e drejtë e individit, në kuptimin që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të përfituar me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 9, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

58. Gjykata ka theksuar se zgjedhja e profesionit, siç parashikohet nga dispozita kushtetuese, është një e drejtë e individit, në kuptimin që ai i përkushtohet një veprimtarie për të siguruar mjetet e jetesës. Kjo e drejtë e individit për të përfituar me punë të ligjshme fiton rëndësi edhe nga pikëpamja sociale, pasi puna si profesion është një vlerë edhe për kontributin që i sjell shoqërisë në tërësi (*shih vendimet nr. 9, datë 23.3.2010; nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, e drejta për ushtrimin e një profesioni mund të kufizohet nga rregullime të arsyeshme që mund t'u atribuohen konsideratave të së mirës së përgjithshme. Nëse ligjvënësi e kushtëzon të drejtën për të nisur një aktivitet profesional me përmbushjen e disa kriterëve të caktuara, duke cenuar kështu të drejtën për të zgjedhur një profesion, në këtë rast rregullimet për të mirën e përgjithshme janë të legjitimuara. Por, këto kufizime duhen bërë vetëm kur veprime të tilla janë absolutisht të nevojshme për të mbrojtur në veçanti interesa të rëndësishëm të komunitetit dhe duhet që në të gjitha këto raste masa kufizuese e përzgjedhur të përmbajë cenimin më të vogël të mundshëm (*shih vendimin nr. 9, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

59. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi ka kaluar me sukses provimin e pranimit, si parakusht për ndjekjen e programit të formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2020–2021, profili prokuror. Në kuadër të këtij kandidimi, ai i është nënshtruar procesit të verifikimit të kriterëve të pranimit, përfshirë atë të pasurisë dhe figurës, duke plotësuar në këtë drejtim formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, në të cilin ka deklaruar se është dënuar penalisht në vitin 2006 me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë.

60. Sikundër u theksua edhe më lart, me vendimin nr. 295, datë 17.12.2020, KLP-ja ka vendosur ndalimin e pranimit të kërkuesit për në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, bazuar në nenin 28, shkronja “d”, të ligjit nr. 96/2016 të kohës, i cili kërkonte që kandidati të mos ishte dënuar me vendim penal të formës së prerë, si dhe nenin 32, pika 4, shkronja “c”, të tij, i cili përcaktonte mospranimin në Shkollën e Magjistraturës edhe për shkaqe të tjera përjashtuese të njohura, të parashikuara sipas ligjit. KLP-ja ka vlerësuar si shkak përjashtues të dhënë të bërë të njohur nga kërkuesi në formularin e vetëdeklarimit, për dënimin penal të tij në mituri me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Bulqizë. Po në këtë drejtim kanë arsyetuar edhe Gjykata Administrative e Apelit edhe Gjykata e Lartë.

61. Në këndvështrim të sa më lart, Gjykata rithekson se garantimi i pastërtisë së figurës së funksionarëve publikë përbën një qëllim të ligjshëm që synon mbrojtjen e pavarësisë së shtetit, rendit demokratik dhe sigurisë kombëtare, në përputhje me parimin e shtetit të së drejtës dhe objektivat e KEDNJ-së. Në këtë kuptim, e drejta për ushtrimin e një profesioni mund të kufizohet për të mbrojtur interesin publik. Nëse vetë ligji e kushtëzon ushtrimin e profesionit me përmbushjen e disa kriterëve specifikë, të cilat cenojnë të drejtën e zgjedhjes së profesionit, por, ndërkohë, këto kriterë janë vënë për të mbrojtur interesin publik, atëherë ato do të konsiderohen kushtetuese (*shih vendimin nr. 9, datë 23.3.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

62. Duke pasur parasysh se ligji nr. 96/2016 ka për qëllim, ndër të tjera, të garantojë integritetin e një kategorie të caktuar të funksionarëve publikë, siç janë kandidatët për magjistratë, Gjykata çmon se ai është në përputhje me frymën e procesit të verifikimit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës së kandidatëve për magjistratë, që të ketë një shkallë kufizimi për pranimin e tyre në Shkollën e Magjistraturës, në rast të mospërmbushjes së një prej kriterëve ligjore të përcaktuara.

63. Për sa më sipër, Gjykata, duke marrë parasysh edhe gjetjen e KLP-së me pasojë skualifikimin nga kandidimi, konsideruar më pas edhe nga Gjykata Administrative e Apelit edhe nga Gjykata e Lartë, konstaton se shkak i ligjor i vendimmarrjes së ndalimit të kërkuesit nga kandidimi për në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës nuk bie ndesh me frymën e ligjit. Interpretimi i ligjit sipas KLP-së dhe gjykatave të zakonshme nuk duket arbitrar në kuptimin kushtetues. Prandaj, Gjykata vlerëson se vendimet gjyqësore nuk i kanë cenuar

kërkuesit të drejtën për akses në funksione publike dhe për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme.

64. Po kështu, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për jetë private, për shkak të pamundësisë së ushtrimit të profesionit të prokurorit, si rrjedhojë e skualifikimit “përrjetë” nga konkurrimi në Shkollën e Magjistraturës, ndërsa subjekti i interesuar, KLP-ja, ka prapësuar se skualifikimi i kërkuesit është bërë në përputhje me ligjin, për shkak të pengesave ligjore të konstatuara gjatë procedurës së verifikimit të kryer ndaj tij.

65. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se e drejta për jetë private nuk mbrohet nga një dispozitë e vetme e Kushtetutës. Ajo nuk ka karakter shterues, por, në thelb, duhet t’i sigurojë individit një hapësirë brenda së cilës ai mund të zhvillojë dhe plotësojë në mënyrë të pavarur personalitetin e tij, ku përfshihet edhe zhvillimi ose ruajtja në një masë të caktuar e marrëdhënieve me njerëzit e tjerë (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 52, datë 1.12.2011; nr. 16, datë 11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

66. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se mosmarrëveshjet e lidhura me punësimin nuk përjashtohen *per se* nga sfera e “jetës private”, në kuptim të nenit 8 të KEDNJ-së. Një kufizim në lidhje me aksesin në një funksion publik mund të ketë pasoja mbi ushtrimin e së drejtës së jetës private, duke pasur parasysh se kjo e ndalon kërkuesin të ushtrojë një profesion që i korrespondon kualifikimeve të tij profesionale (*shih Naidin k. Rumanisë, 21 tetor 2014, § 32*). Sipas GJEDNJ-së, neni 8 është i zbatueshëm vetëm kur këto pasoja janë shumë serioze dhe prekin jetën private në një masë shumë domethënëse (*shih Denisov k. Ukrainës [DHM], nr. 76639/11, 25 shtator 2018, § § 115, 116*).

67. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës për jetë private nuk janë ngritur në nivel kushtetues, pasi ai nuk ka arritur të parashtrojë para Gjykatës ndërhyrjen në një masë domethënëse nga KLP-ja dhe gjykatat në këtë të drejtë të tij, duke konsideruar faktin se ndalimi i tij lidhet veç me profesionin e magjistratit. Gjykata konstaton se kërkuesit nuk i është ndaluar aksesin në çdo funksion publik ose veprimtari që lidhet me profesionin e juristit, por potencialisht vetëm në ushtrimin e detyrës së magjistratit. Në këtë aspekt, të gjitha profesionet e tjera, potencialisht të mundura për kërkuesin, garantojnë të drejtën për fitimin e mjeteve të jetesës me punë të ligjshme. Për më tepër, kalimi me sukses i provimit të pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës nuk nënkupton domosdoshmërisht fitimin e së drejtës së ushtrimit të profesionit të magjistratit, pasi një gjë e tillë është e ndërruar nga përfundimi me sukses i këtij programi, sikundër edhe nga suksesi i kalimit të proceseve të tjera ligjore deri në emërimin dhe fitimin e statusit të magjistratit.

68. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për jetë private, në drejtim të dinjitetit, është i pabazuar.

69. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 23.3.2023

Shpallur, më 24.4.2023

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Ilir Toska, Sonila Bejtja

Anëtare kundër: Marsida Xhaferllari

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuetit Shiqiri Manjani, me objekt: “Shfuqizimi i vendimeve të KLP-së, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën”, unë, gjyqtarja Marsida Xhaferllari, jam kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e ankimit, pasi vlerësoj se kërkueti i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtroj në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Në mënyrë të përmbledhur rezulton se kërkueti më datë 16.7.2020 është shpallur fitues në provimin e pranimit të programit të formimit fillestar për prokuror të Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2020–2021. Më datë 17.7.2020 KLP-ja ka filluar procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës. Gjatë këtij procesi, KLP-ja më datë 17.12.2020, bazuar në nenin 32, pika 4, shkronja “c”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji për statusin*), ka vendosur ndalimin e pranimit të kërkuetit në programin e formimit fillestar, për shkak të dënimit të tij me vendim penal të formës së prerë. Konkretisht, kërkueti në moshën 15-vjeçare është proceduar penalisht, nën masën e sigurimit “Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore” për veprën penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 134 i KP-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë, me vendimin nr. 48, datë 21.11.2006, me gjykim të shkurtuar, e ka deklaruar fajtor sipas akuzës dhe e ka dënuar me 8 muaj burgim, ekzekutimi i të cilit është pezulluar bazuar në nenin 59 të KP-së, duke e vënë atë në provë për 3 vjet. Vendimi është bërë përfundimtar, pasi nuk është ankimuar në gjykatat më të larta. Dënimi penal është deklaruar nga vetë kërkueti përgjatë procesit të verifikimit të figurës të zhvilluar nga KLP-ja në formularin e dekriminalizimit, bazuar në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (*ligji për dekriminalizimin*), ndërsa institucionet shtetërore përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave të figurës kanë informuar KLP-në se nuk ka të dhëna negative për kërkuetin.

3. Në marrjen e vendimit të datës 17.12.2020 për ndalimin e pranimit të kërkuetit në Shkollën e Magjistraturës, KLP-ja ka interpretuar përmbajtjen e nenit 28, shkronja “d” të ligjit për statusin, i cili në atë kohë parashikonte si kusht ndalimi “nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë”. Ajo ka arsyetuar se ekzistenca e një dënimi penal përbën kriter ndalues, që nuk lidhet me institutin e rehabilitimit dhe se ndalimi i kërkuetit gjen mbështetje në nenin 6/1 të Kushtetutës dhe ligjin për dekriminalizimin. Ky i fundit, sipas KLP-së, përbën një udhëzues për listën e veprave penale që cenojnë integritetin e funksionarit publik dhe është i zbatueshëm edhe për prokurorët. Ndonëse kërkueti është ankuar në Gjykatën Administrative të Apelit, kjo e fundit më datë 18.3.2021 ka vendosur rrëzimin e padisë, ndërsa Gjykata e Lartë më datë 17.3.2022 ka vendosur mospranimin e rekursit të tij.

4. Më datë 30.5.2021, përpara dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë, ka hyrë në fuqi ligji nr. 50/2021, që ndryshoi përmbajtjen e nenit 28, shkronja “d” të ligjit për statusin, duke parashikuar tashmë si kusht ndalimi për individin kur “nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose prokurorit ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal”.

5. Mbi këto fakte, kërkueti ka pretenduar se vendimet e KLP-së dhe të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm në çështjen e tij cenojnë parimin e shtetit të së drejtës, parimin e sigurisë juridike, parimin e barazisë para ligjit, të drejtën për proces të rregullt ligjor (në aspektet e gjykimit të drejtë, standardit të arsyetimit të vendimit, paanshmërisë së gjykatës, shqyrtimit efektiv të çështjes, si dhe së drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur), të drejtën për arsim, të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme të zgjedhur vetë dhe të drejtën për jetë private, të garantuara nga nenet 4, 42, 57, 49, pika 1 dhe 35 të Kushtetutës. Sipas tij, cenimi i të drejtave kushtetuese është në shkelje të kriterëve të nenit 17 të Kushtetutës, pasi nuk është bërë me ligj të miratuar nga Kuvendi.

6. Subjekti i interesuar, KLP-ja, ka prapësuar se pretendimet e kërkuetit janë të pabazuara, pasi rehabilitimi nuk e zbeh fuqinë e dënimit penal; ligji nr. 50/2021 ka plotësuar kriterin

ekzistues dhe nuk ka krijuar një të ri; kalimi i provimit nuk mjafton për t'u pranuar në Shkollën e Magjistraturës; procesi i verifikimit është kryer në përputhje me ligjin dhe kërkuesi është njoftuar me aktet, si dhe është dëgjuar rregullisht; vendimet e dhëna respektojnë standardin e arsyetimit; Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve dhe ka sqaruar se ndalimi lidhet me natyrën e veprës penale të kryer, ndaj nuk ka pasur trajtim të pabarabartë.

7. Në përfundim të gjykimit kushtetues, shumica, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar se janë të papranueshme dhe nuk mund të shqyrtohen në themel: i) pretendimet e kërkuesit për mënyrën e zbatimit të ligjit dhe efektet prapavepruese të tij, pasi nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk provohet se kanë cenuar të drejtat kushtetuese (*shih paragrafin 20 të vendimit*); ii) pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë, pasi nuk është ngritur në nivel kushtetues (*shih paragrafin 20 të vendimit*); iii) e drejta kushtetuese për arsim, pasi nuk përfshin shkollimin në Shkollën e Magjistraturës, në kuptim të neneve 136/a dhe 148/ç të Kushtetutës (*shih paragrafin 21 të vendimit*).

8. Lidhur me themelin e çështjes, shumica ka vlerësuar, se: i) pretendimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe për mbrojtje efektive nuk është i bazuar, pasi kërkuesit përgjatë procesit administrativ i janë bërë të ditura të gjitha aktet dhe ai ka paraqitur kundërshtimet e tij (*shih paragrafët 26–27 të vendimit*); ii) pretendimi për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është i pabazuar, pasi vendimet e kundërshtuara nuk rezultojnë të jenë të paqarta, alogjike ose në mungesë të elementeve formale, ndërsa Gjykata e Lartë i ka pasqyruar në pjesën hyrëse pretendimet e tij dhe i ka trajtuar ato në pjesën përshkruese-arsyetuese të vendimit (*shih paragrafët 32–33 të vendimit*); iii) pretendimi për cenimin e parimit të barazisë para ligjit është i pabazuar, pasi specifikat e çështjes së kërkuesit dhe çështjes tjetër të referuar prej tij janë të ndryshme (*shih paragrafin 42 të vendimit*); iv) pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk bazohet në argumente kushtetuese, pasi pritshmëritë e ligjshme krijohen vetëm në përfundim të procesit të verifikimit dhe jo gjatë fazave të ndërmjetme të tij (*shih paragrafin 51 të vendimit*); v) pretendimet për cenimin e të drejtave për akses në funksione publike dhe për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme janë të pabazuara, pasi ato mund të kufizohen për qëllimin e ligjshëm të garantimit të pastërtisë së figurës së funksionarëve publikë. Ndalimi i kërkuesit në Shkollën e Magjistraturës nuk bie ndesh me frymën e ligjit. Interpretimi i ligjit sipas KLP-së dhe gjykatave të zakonshme nuk duket arbitrar në kuptimin kushtetues (*shih paragrafët 61–63 të vendimit*); vi) pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për jetë private është i pabazuar, pasi ai nuk ka arritur të parashtrojë para Gjykatës ndërhyrjen në një masë domethënëse nga KLP-ja dhe gjykatat. Kërkuesit nuk i është ndaluar akses në çdo funksion publik ose çdo veprimtari që lidhet me profesionin e juristit, por potencialisht vetëm në ushtrimin e detyrës së magjistratit (*shih paragrafin 67 të vendimit*).

9. Në ndryshim nga shumica, vlerësoj se pretendimet e kërkuesit duhet të ishin shqyrtuar në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Në këtë mënyrë, Gjykata duhet të kontrollonte nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, bazuar në parimin e subsidiaritetit dhe në përputhje me kompetencat e tyre, kanë riparuar shkeljet eventuale të KLP-së. Në kushtet kur argumenti kryesor i kërkuesit lidhet me mënyrën e interpretimit të ligjit dhe veprimin e tij në kohë, shkaku përcaktues i cenimit është rezultat i drejtpërdrejtë dhe i lidhur ngushtë me procesin e zhvilluar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në aspektin e arsyetimit të vendimit.

10. Ashtu siç pohon shumica, e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 4.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimin nr. 43, datë 27.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Me arsyetimin, gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet

që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në çështjen konkrete vlerësoj se kërkuesit nuk i është respektuar kjo e drejtë kushtetuese, për arsyet e mëposhtme.

12. *Së pari*, vendimi i KLP-së nuk ka treguar me qartësi ligjin e zbatueshëm që e ka çuar atë të vendosë ndalimin e pranimit të kërkuesit në Shkollën e Magjistraturës. KLP-ja në vendimin e saj i është referuar edhe ligjit për dekriminalizimin, me arsyetimin se ky ligj përbën një udhëzim për veprat penale që ndalojnë emërimin në funksione publike. Ky arsyetim bie ndesh haptazi me ligjin për dekriminalizimin, i cili në nenin 2, pika 1, shkronja “ç” dhe nenin 4, pika 4, parashikon ndalimin e emërimit të individit të dënuar me të paktën gjashtë muaj burgim me vendim të formës së prerë, për një krim me dashje, por ky ndalim zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burgim deri në momentin e rehabilitimit. Në çështjen konkrete, kërkuesi është proceduar penalisht nën masën e sigurimit “Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore”, ndërsa dënimi penal me 8 muaj burgim është pezulluar, duke u urdhëruar vënia e tij në provë, me kusht që gjatë tre vjetëve të provës të mos kryente vepër tjetër penale. Me fjalë të tjera, ndaj kërkuesit është caktuar alternativë e dënimit me burgim, ndaj ai nuk ka vuajtur asnjë ditë burgim. Për më tepër, sipas nenit 69, shkronja “b”, të KP-së, individ i rehabilitohet kur është dënuar me burgim gjashtë muaj gjer në pesë vjet dhe gjatë pesë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk ka kryer vepër tjetër penale.

13. Po ashtu, KLP-ja, gjatë diskutimeve në mbledhjen plenare, i është referuar edhe projektligjit të përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, që propozonte ndryshimin e shkronjës “d” të nenit 28, ndonëse kjo nismë në kohën e vendimmarrjes nuk rezultonte të ishte pjesë e rendit juridik dhe të ishte depozituar për miratim pranë Kuvendit. Ky arsyetim i vendimmarrjes së KLP-së, përveçse nuk përmbush standardin kushtetues të arsyetimit, bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës, i cili përfshin sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike (*shih vendimin nr. 29, datë 9.11.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Shteti i së drejtës i detyron të gjitha institucionet shtetërore të veprojnë sipas së drejtës në fuqi, si dhe garanton supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Por ai nuk konsiston vetëm në detyrimin për zbatimin e tërësisë së normave juridike, por në sigurimin e kontrollit gjyqësor se si autoritetet i respektojnë ato (*shih vendimin nr. 29, datë 2.7.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. *Së dyti*, nga parimi i shtetit të së drejtës buron e drejta e kujtdo për një proces të rregullt ligjor. E drejta e individit kundër veprimeve të paligjshme të individëve të tjerë ose institucioneve shtetërore nuk duhet të mbrohet vetëm formalisht, por dhe realisht e efektivisht (*shih vendimin nr. 10, datë 11.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, ndonëse kërkuesi është ankuar gjyqësisht, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur rrëzimin e padisë së tij, duke arsyetuar se vendimi i KLP-së është i bazuar në rrethanat e faktit dhe në përcaktimet e ligjit, duke iu referuar për këtë të fundit ligjit për statusin, nenit 28, shkronja “d”, i cili, sipas saj, ka përmbajtje të qartë gramatikore dhe logjike, që përjashton rehabilitimin. Po ashtu, kjo gjykatë ka konkluduar se ligji për statusin vendos një standard më të lartë dhe se nuk mund të konkurrohet nga akte të tjera ligjore; se KLP-ja nuk ka shkelur parimin e ligjshmërisë dhe nuk ka marrë vendim në shkelje të ligjit. Lidhur me referencën e KLP-së në projektligj, Gjykata Administrative e Apelit është shprehur se pretendimi është i pabazuar në prova, ndonëse këto diskutime të KLP-së janë bërë zyrtarisht në seancë plenare dhe janë regjistruar e publikuar në faqen e saj. Me anë të këtij arsyetimi, Gjykata Administrative e Apelit ka dështuar t’i sigurojë mbrojtje reale dhe efektive kërkuesit, duke mos riparuar shkeljet eventuale në arsyetimin e KLP-së. Për rrjedhojë, arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Apelit nuk ka përmbushur funksionin e vendimit të drejtë.

15. *Së treti*, Gjykata e Lartë, ndonëse kërkuesi ka parashtruar pretendime për zbatimin e ligjit dhe veprimin e tij në kohë, ka vendosur mospranimin e rekursit, me konkluzionin se ai nuk përmban shkaqe të parashikuara nga ligji. Në pjesën arsyetuese Gjykata e Lartë shpjegon kuptimin e ligjit dhe veprimin e tij në kohë, që *prima facie* nuk përputhet me konkluzionin se pretendimet në rekurs nuk përmbajnë shkaqe për shqyrtimin e tij.

16. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se ekzistenca e dënimit penal në kohën e vendimmarrjes së KLP-së konsiderohej kriter ndalues dhe ky kufizim ishte në funksion të garantimit të integritetit. Sipas Gjykatës së Lartë, ky kufizim tashmë është qartësuar me ligjin nr. 51/2021, që parashikon

në mënyrë eksplicite se instituti i rehabilitimit nuk merret në vlerësim. Ajo shprehet se mënyra e ekzekutimit të dënimit penal është faktor jorelevant në drejtim të integritetit. Besimi i publikut në integritetin e sistemit gjyqësor është jetik, duke pasur në konsideratë edhe kushtet që diktuan ndërmarrjen e reformës së thellë në drejtësi në vitin 2016. Edhe nëse aplikohet ligji nr. 50/2021, vepra penale e vjedhjes është për nga natyra e rëndë, realizohet me dashje dhe është diskredituese për gjyqtarin ose prokurorin. Kësisoj nuk mund të analizohet si kriter lehtësues fakti që kërkuesi këtë vepër e ka kryer kur ka qenë i mitur.

17. Pajtohem plotësisht me Gjykatën e Lartë kur ka theksuar se besimi i publikut në integritetin e sistemit gjyqësor është jetik, por fitimi dhe ruajtja e besimit publik kërkon gjithashtu respektimin e shtetit të së drejtës nga vetë gjykatat në dhënien e drejtësisë. Për këtë shkak, arsyetimi bindës, i qartë dhe sa më uniform i vendimeve gjyqësore merr rëndësi përcaktuese. Në këtë situatë, arsyetimi i vendimit të mospranimi të rekursit prej Gjykatës së Lartë jo vetëm bën ndesh haptazi me arsyetimin e Gjykatës Administrative të Apelit, e cila thekson se neni 28, shkronja “d”, i ligjit për statusin kishte përmbajtje të qartë dhe logjike, por i jep shkas pretendimit të kërkuesit për zbatimin e ligjit në kohë, sepse duket që Gjykata e Lartë ka zbatuar në rastin e tij një ligj të miratuar më vonë.

18. Po ashtu, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar përse ndalimi i përjetshëm i kërkuesit për t’u pranuar në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës është proporcional dhe nuk cenon dinjitetin njerëzor. Në këtë pikë duhet evidentuar se kërkuesi e ka kryer veprën penale dhe është dënuar në moshën 15-vjeçare, kur aftësia e tij për të kuptuar veprimet dhe pasojat ka qenë e kufizuar, rrethana të cilat duket se janë mbajtur në konsideratë gjatë procedimit të tij penal, si në caktimin e masës së sigurimit “Detyrim për paraqitje në Policinë Gjyqësore”, ashtu edhe në dënimin penal me masë alternative. Duke mbajtur në konsideratë se sipas nenit 54, pika 1, të Kushtetutës të miturit gëzojnë mbrojtje të posaçme nga shteti, arsyetimi i Gjykatës së Lartë se “nuk mund të analizohet si kriter lehtësues fakti që ai këtë vepër e ka kryer kur ka qenë i mitur” është i pamjaftueshëm në nivel kushtetues. Për më tepër, ky arsyetim është i pamjaftueshëm edhe në kontekstin aktual të zhvillimeve ligjore dhe institucionale, ku Shqipëria ka bërë progres për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në veçanti për drejtësinë penale për të mitur, duke u kujdesur që veprat penale dhe dënimet eventuale të mos jenë një pasaportë shoqëruese e të miturit përgjatë gjithë jetës së tij. Në këtë drejtim, legjislacioni më i fundit për drejtësinë për të mitur, i miratuar në kuadër të reformës në drejtësi, ka parashikuar kufizime të posaçme në njohjen e të dhënave të të miturve në konflikt me ligjin gjer në asgjësimin e fashikullit personal të tij, si dhe kërkon që të ndërmerren hapa për të promovuar aftësinë e tij për të kuptuar dhe marrë pjesë. Me fjalë të tjera, jeta private e të miturit gëzon mbrojtje dhe garanci specifike, ndërsa vetë ai trajtohet në një mënyrë që merr plotësisht parasysh moshën, nivelin e pjekurisë dhe kapacitetet intelektuale e emocionale.

19. Së katërti dhe së fundmi, arsyetimi i gjykatave të zakonshme dështon të tregojë për kërkuesin dhe publikun se është respektuar parimi i barazisë. Ashtu siç parashtrohet kërkuesi, një individ tjetër në të njëjtin vit akademik, ndonëse është ndaluar nga KLP-ja, bazuar në vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe Gjykatës së Lartë, është pranuar në programin fillestar të Shkollës së Magjistraturës në të njëjtin vit akademik. Në atë rast bëhej fjalë për veprën penale, krim, të drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt, të parashikuar nga neni 291 i KP-së, për të cilën individ tjetër në vitin 2019 dhe në moshë madhore ishte dënuar me 20 ditë burgim, i cili ishte pezulluar bazuar në nenin 63 të KP-së dhe ishte zëvendësuar me masën alternative të kryerjes së 80 orëve punë në interes publik brenda gjashtë muajve. Mbi këto fakte, Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se dënimi penal ishte i paqenë, ndërsa Gjykata e Lartë ka arsyetuar se vepra penale e vjedhjes e kryer nga i mituri është e rëndë dhe diskredituese, ndërsa vepra penale e drejtimit të mjetit të parregullt e kryer nga madhori nuk është e rëndë. Ky arsyetim i Gjykatës së Lartë është i paqartë, pasi referuar dispozitave relevante të KP-së, ligjvënësi i ka vlerësuar në të kundërt, konkretisht krimi i vjedhjes i kryer nga i mituri është i dënueshëm gjer në një vit e gjysmë burgim, sipas neneve 134 dhe 51 të KP-së të kohës, ndërsa drejtimi i mjetit në mënyrë të parregullt i kryer nga madhori është krim i dënueshëm gjer në tre vjet burgim, sipas nenit 291 të KP-së.

20. Për sa më lart, vlerësoj se në rastin e kërkuesit nuk konstatohet që vendimet e kundërshtuara arsyetojnë se janë balancuar mjaftueshëm interesat e mbrojtur kushtetues të tij

kundrejt interesave publikë dhe se ishte detyrë, më së paku, e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të argumentonin nëse dhe mbi çfarë baze duhet të supozohej se kërkuesi që kishte kryer një gabim në moshë të mitur dhe referuar masës së dënimit nuk konsiderohet potencialisht i rrezikshëm, nëse do të pranohej si magjistrat, do të vepronte në një mënyrë që mund të dëmtonte besimin e publikut në integritetin profesional, veçanërisht për sa i përket interesit publik për një administrim funksional të drejtësisë.

21. Argumenti i shumicës se në rastin konkret kufizimi është vendosur me ligj, nuk është i mjaftueshëm, pasi çështja konkrete kërkonte një analizë më të thelluar për të vlerësuar nëse interpretimi i ligjit ishte arbitrar në atë masë që kishte vendosur një ndalim absolut përtej nevojës që ekzistonte dhe që e kalonte testin e domosdoshmërisë. Kjo pasi në procesin e vendosjes së një ndalimi absolut, pa mundësi rishikimi, shumica duhet të sigurohej që pasojat e një ndalimi të tillë janë proporcionale. Ndërkohë që ekzistojnë masa të tjera më të buta, të cilat do të kishin qenë më pak kufizuese për të drejtat themelore. Pra, në këtë rast do të duhej të shtrohej diskutimi nëse kufizimi i të drejtave të kërkuesit, si rrjedhojë e interpretimit të ligjit, ishte i pajtueshëm me parimin e proporcionalitetit dhe, rrjedhimisht, me Kushtetutën, që do të thotë se: i) duhet të ketë një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet metodave të përdorura dhe qëllimeve që duhen arritur; ii) metodat duhet të jenë të nevojshme për të mbrojtur interesin në fjalë; iii) rezultatet e tyre duhet të jenë proporcionale me barrën që u ngarkohet individëve.

Anëtare: Marsida Xhaferllari